

### **Procedurë mbi Njoftimet e Kontratave Dypalëshe**

Në përputhje me parashikimet e pikës 3 të Vendimit të Bordit të ERE-s Nr. 347 datë 27.12.2022 “Mbi për miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (Rregullat e Alpex Përkufizimet, Procedura e Tregtimit si dhe Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes)”, me fillimin e operimit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a., në fazën “go-live”, Rregullat e Përkohshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, të miratuara me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 139, datë 15.08.2016 do të shfuqizohen.

Për sa më sipër, me qëllim përmbushjen e gjithë detyrimeve të parashikuara në aktet ligjore, nënligjore dhe rregullatore nga ana e të gjitha Palëve Përgjegjëse Balancuese dhe nga ana e OST sh.a., ju njoftojmë se:

Çdo Palë Përgjegjëse Balancuese është e detyruar të njoftojë në OST sh.a., sipas Formatit “Njoftim Kontrate” bashkëlidhur kësaj procedure: transaksionet dypalëshe në tregun me shumicë të energjisë elektrike, për të cilat janë lidhur kontrata shit/blerje të energjisë elektrike për periudha kohore të përcaktuara.

Pala Përgjegjëse Balancuese do të njoftojnë OST-në për kontratat përkatëse, duke identifikuar për secilën prej tyre këto të dhëna:

- i. Palët kontraktuese.
- ii. Pikat e lëvrimit/tërheqjes
- iii. Kohëzgjatjen e kontratës.
- iv. Sasitë e kontraktuara.

Kërkesat e mësipërme do të zbatohen për gjithë kontratat dypalëshe: Import/ Export/ Furnizim/ Tregtim. Për njoftimet e kontratës do të zbatohet konfidencialiteti dhe OST-së nuk i jepet njoftim për informacion komercial (p.sh. për çmimet). Përjashtim nga detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit përbëjnë rastet e parashikuara me ligj dhe kur Pala Përgjegjëse Balancuese është e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

Njoftimi i kontratës dorëzohet në OST sh.a. nga Pala Përgjegjëse për Balancim, në format elektronik, në adresën [ost\\_ot@ost.al](mailto:ost_ot@ost.al), jo më vonë se 4 ditë para ditës së lëvrimit (ose më parë nëse ky afat bie ditë pushimi).

Transaksionet dypalëshe në tregun me shumicë të energjisë elektrike, për të cilat janë lidhur kontrata shit/blerje të energjisë elektrike për periudha kohore të përcaktuara, do të ekzekutohen vetëm pasi janë përmbushur detyrimet e mësipërme për njoftimin e tyre në OST sh.a.

OST do të konfirmojë vlefshmërinë e kontratës brenda ditës së punës nga marrja e “Njoftimit të Kontratës”. Nëse OST sh.a. nuk shprehet brenda këtij afati, “Njoftimi i Kontratës” konsiderohet i konfirmuar.

Lideri i Grupit të Balancimit është përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve dhe komunikimeve sipas kësaj procedure, për secilin prej pjesmarrësve të grupit të tij të balancimit.

**ADMINISTRATORI I OST SH.A**



**Skerdi Drenova**  
SISTEMI I  
TRANSMETIMIT

Njoftim Kontrate  
Për OST

Nr. (Nr rëndor i "Njoftim Kontrate", për vitin kalendarik korent ) Datë (data e dërgimit të "Njoftim të Kontrate" në OT)

Ju njoftojmë se :

- Shitësi (Emri i Palës shitëse në kontratë ), me (Kodi EIC i subjektit shitës )
- Blerësi (Emri i Palës blerëse në kontratë), me (Kodi EIC i subjektit blerës )

Sipas kontratës nr.      së datës ( dd/mm/yyyy ) do të shkëmbejnë midis tyre energjinë elektrike, si vijon:

1. Sasia e energjisë elektrike ( *sasia e kontraktuar [MWh]* )
2. Vlefshmëria e kontratës nga data ( *dd / mm / yyyy* ) deri datën ( *dd / mm / yyyy* )
3. Energjia elektrike do të lëvrohet në ( *Pika në Sistemin e Transmetimit / Sistemin e Shpërndarjes* )
4. Pala Përgjegjëse për Balancën (PPB) kundrejt OST është ( *Emri i PPB* ) me ( *Kodi EIC i PPB* )
5. Grafiku / profili ditor i lëvrimit do të jetë:

Ora	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	Σ	
MWh																										

Kjo kontratë bëhet efektive pas konfirmimit nga OST.

( *Emri i Palës së Tregut* )